



---

**VENDIM**  
**Nr.19 Datë 08.03.2010**  
**PËR**  
**SHTYRJEN E AFATIT PËR REALIZIMIN E KUSHTEVE TE**  
**VENDOSURA NGA ERE SHOQËRISË “ALBANIAN GREEN**  
**ENERGY” SH.P.K**

Në mbështetje të neneve 9, 13 pika 1, gërma “a”, dhe 15 të Ligjit Nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 121 dhe 128 të Ligjit nr.8485, datë 12.05.2008 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 08.03.2010, mbasi shqyrtoi informacionin e Drejtorise se Licensimit dhe Monitorimit të Tregut për shtyrjen e afateve për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE shoqërisë “ALBANIAN GREEN ENERGY” sh.p.k,

**Dhe duke konsideruar :**

Kompleksitetin e problematikes që i licensuari ka hasur për fillimin e punimeve për ndërtimin e centraleve, TEC me biomasë të lëngshme për shkak se ende nuk ka marrë autorizimin e Linjës Tregëtare nga pala Italiane, duke qene se ndertimi i linjave të interkonjeksionit, pervec etapave administrative ne te cilat kalon cdo projekt perben akoma nje teknologji jo shume te njohur ne vend dhe qe kerkon asistencen teknike te huaj,

Për gjithë sa më sipër,

**Vendosi:**

1. Në vendimin nr.89, datë 06.08.2008, për dhenien e licensës shoqërisë ”Albanian Green Energy” sh.p.k në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike si dhe prodhimin e energjisë elektrike, bllok motore gjeneratorë të ushqyer me biomasë të lëngshme të bëhën këto ndryshime:

**Pika 1** gërma “d” të ndryshohet si më poshtë:

*d.1. Afati i fillimit të punimeve për realizimin e projektit do të jetë deri në 18 muaj në përputhje të afatit të përcaktuar ne lejen e METE-s nr. 4/1, datë 07.12.2009, të miratuar me VKM nr. 31, datë 20.01.2010, për ndërtimin e Linjës Tregëtare të Interkonjeksionit.*

*d.2. Koha e zbatimit të gjithë projektit përfshirë dhe kolaudimin e veprës do të jetë 36 muaj nga realizimi i afatit të përcaktuar në pikën d.1.*

2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë shoqërinë “Albanian Green Energy” për Vendimin e Bordit të Komisionereve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**Kryetari i ERE-s  
Bujar Nepravishta**